

Salih el-Feuzan

MËSIME  
NGA  
KURANI  
FISNIK

# **Mësime nga Kur'ani Fisnik**

**Salih ibn 'Abdilah el-Feuzan**

Marrë nga libri i tij Durus min el-  
Kur'an el-Kerim (f.5-30)

*Me emrin e Allahut, të Gjithmëshirshmit, Salah dhe Selam qofshin mbi të Dërguarin e Tij të fundit dhe mbi të gjithë anëtarët e familjes së tij dhe shokët dhe ata që ndjekin rrugën e tij. Në vazhdim...*

## **Rëndësia e teuhidit dhe pasojat nga mospërfillja e tij**

Dikush mund të thotë, dhe tashmë është thënë, “Ç’është me ty që gjithnjë fokusohesh në teuhid dhe flet aq shumë për të?! Dhe ti nuk e merr në konsideratë gjendjen e muslimanëve në ditët e sotme, të cilet janë duke u vrarë dhe kërcënuar me zhdukje në mbarë

botën, dhe janë duke u persekutuar nga perandorët e mosbesimit në çdo vend?!”

Atëherë ne themi, dhe sukcesi është me Allahun:

Teuhidi është themeli mbi të cilin është ngritur kjo fe e drejtë. Atëherë, të fokusohesh në të do të thotë të fokusohesh në atë që është më e rëndësishmja. Nëse hedhim një shikim në Kuranin Fisnik do të shohim se ai vazhdimisht parashtron çështje të teuhidit, saqë nuk ekziston as edhe një sure e vetme në Kuran e që të mos bëjë fjalë për teuhidin, duke e qartësuar atë dhe duke ndaluar nga ajo që bie

ndesh me të. Ishte el-Imam ibn el-Kajjimi i cili theksoi se i tërë Kurani është rreth teuhidit, meqenëse nuk përmban tjetër vetëm se:

o Informata për Allahun dhe për Emrat e Cilësitë e Tij – Ky është teuhidi për të cilin duhet të kemi dije, i quajtur teuhid er-rububijeh.

- Urdhrat për adhurimin e Allahut të vetëm e pa shokë dhe ndalimet e adhurimit të tjetërkujt pos Tij – Ky është teuhid që ne duhet ta vëjmë në praktikë, i quajtur teuhid el- uluhijeh.

- Urdhrat për bindjen ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (salallahu ‘alejhi ue selam) dhe

ndalesat për mosbindje ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (salallahu 'alejhi ue selam) – Këto janë kushtet që teuhidi të jetë i realizuar dhe i kompletuar.

- Informatat për atë që Allahu ka përgatitur për njerëzit e teuhidit, shpërblimet, suksesi, shpëtimi dhe triumfit në këtë dhe jetën Tjetër, dhe dënimet të cilat janë përgatitur për njerëzit e shirkut në këtë jetë, dhe torturat e përhershme të përgatitura për ta në hyrjen njëkahëshe për në Zjarr të Xhehenemit – E para është për njerëzit që realizojnë teuhidin, tjetra për ata që nuk e realizojnë

atë.1

Kështu që i tërë Kur'ani është i përqendruar rreth teuhidit. Sikur të mendoje për suret e shpallura në Meke, do të gjeje se shumica e tyre fokusohen plotësisht në teuhid. Kjo është për shkak se Profeti (salallahu 'alejhi ue selam) qëndroi në Meke për 13 vite duke thirrur në teuhid dhe duke paralajmëruar kundër shirkut. Pjesa më e madhe e detyrimeve fetare si zekati, agjërimi, Haxhi, çështjet e hallallit dhe haramit, transaksionet në biznes, etj. nuk qenë shpallur deri pas Hixhrit në Medine. Legalizimi i namazit është përjashtim në këtë çështje,

sepse ai qe bërë detyrim gjatë kohës kur Profeti (salallahu ‘alejhi ue selem) ishte akoma në Meke në Natën e el-Mi’raxhit, kur ai (salallahu ‘alejhi ue selem) kishte udhëtuar natën (në Jerusalem)<sup>2</sup>, por kjo ishte pak kohë para Hixhretit.

---

2.Shiko Medarixhus-Salikin (3/468) për detale

3.Siç është gjetur në transmetimet muteuatir për Udhëtimin e Natës (el-Mi’raxh). Shiko transmetimin ahad të Enesit në el-Bukhari, Kaptina e Teuhidit (Kaptina 37,



Hadithi 7517)[13/583] dhe  
Muslim, Kaptina e Imanit  
(Kaptina 74, Hadithi 162)

---

Pra pjesa më e madhe e sureve të shpallura para se Profeti (salallahu 'alejhi ue selam) të bënte hixhret ishin plotësisht të fokusuara në teuhid, duke treguar në këtë mënyrë se sa i rëndësishëm është ai. Për më shumë, obligimet fetare nuk qenë shpallur derisa teuhidi u prezantua dhe u vendos në shpirtat e njerëzve, dhe 'akideja korrekte i lëshoi rrënjët. Me të vërtetë veprat

nuk mund të jenë korrekte vetëm se me teuhid, e jo duke pasur për bazë diç tjetër pos teuhidit.

Kurani ilustron se të Dërguarit (alejhim es-Selatu ues-Selam) të gjithë filluan misionin e tyre duke ftuar njerëzit në teuhid para çdo gjëje tjetër, siç thotë Allahu<sup>3</sup>:

**“Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t'u thonë: ‘Adhurojeni vetëm Allahun, e largojuni djajve!’**

Allahu gjithashtu thotë<sup>4</sup>:

**“Ne nuk dërguam asnjë të dërguar para teje e të mos i kemi shpallur atij se: ‘Nuk ka zot tjetër përveç Meje, pra më adhuroni!’**

Dhe secili profet i tha popullit të tij:

**“O populli im, adhurojeni Allahun, nuk keni zot tjetër pos Tij!”**

Pra, kështu ishte çështja e të dërguarve – ata filluan me teuhid.

Ngjashëm edhe thirrësit dhe rigjallëruesit të cilët pasojnë të dërguarit duhet të fillojnë duke u fokusuar në teuhid. Kështu është për shkak se çdo da’ueh (thirrje) që nuk ndërtohet mbi teuhid, është thirrje jo frytdhënëse dhe nuk e arrin qëllimin e saj dhe nuk ka asnjë rezultat pozitiv në të. Çdo da’ueh që nuk fokusohet në teuhid është

thirrje e humbur, dhe pa rezultate. Kjo është një gjë mirë e njohur dhe e parë kudo.

---

4. Kuptimi i sures en-Nehl (16):36 5.Kuptimi i sures el-Enbija (21):25 6.Kuptimi i sures

---

el-Araf (7):59

Në anën tjetër, çdo da'ueh në qendër të të cilës gjendet teuhidi, është thirrje me të vërtetë e suksesshme, me Lejen e Allahut. Thirrje nga e cila përfiton shoqëria dhe sjell shumë frute. Historia dëshmon për këtë.

Kështu që nuk është se ne nuk e përfillim çështjen e Muslimanëve, përkundrazi, ne jemi shumë të shqetësuar për ta. Ne jemi duke i ndihmuar ata dhe përpiqemi të pengojmë çdo të keqe nga përfshirja e tyre duke përdorur të gjitha resurset tona. Nuk është i lehtë për ne fakti se Muslimanët po vriten dhe po dëbohen, por nuk është brengosje e vërtetë për situatën e Muslimanëve ajo nëse ne e shtyjmë veten tonë për të derdhur lot josinqerisht, apo ta mbushim botën me fjalë e shkrime, klithma e vajtime... me të vërtetë kjo nuk rregullon asgjë.

Gjetja e zgjidhjes reale për problemet e Muslimanëve kërkon nga ne që të hulumtojmë shkaqet që kanë prurë deri tek keqtrajtimet e hidhura ndaj Muslimanëve nga duart e armiqve të tyre.

Çka shkaktoi që armiqtë e Muslimanëve të arrijnë dhe të ushtrojnë autoritet mbi ta?

Kur shikojmë në botën Muslimane, ne nuk shohim ndonjë angazhim serioz për Islam nga shumë nga ata që ia atribuojnë veten atij, me përjashtim të një pakice të cilët Allahu i ka mëshiruar. Ajo çka shohim ne janë Muslimanë vetëm me emra, 'akideja

e shumicës prej tyre ka humbur. Ata adhurojnë të tjerë përpos Allahut, duke i thirrur të shenjtit dhe njerëzit e ndershëm, duke shkuar pas varreve dhe statujave, duke mos e falur namazin, duke mos e dhënë zekatin, duke mos agjëruar, etj. Ata nuk i kryejnë detyrimet themelore ndaj Allahut, madje ata as që e mbledhin fuqinë e tyre dhe nuk përgatiten fizikisht për t'i luftuar jobesimtarët! Kështu është rasti me shumicën e atyre që ia atribuojnë veten e tyre Islamit – ata e kanë humbur fenë e tyre, kështu që Allahu, i Plotfuqishmi dhe i Madhërishmi, u sjelli atyre humbjen.

Faktori kryesor që i shpiu ata në nënshtrimin ndaj këtyre ndëshkimeve, është shkujdesja e tyre në raport me çështjet e teuhidit dhe rënia e tyre në shirk të madh, në atë që ata nuk e ndalonin njëritjetrin prej tij dhe as që brengoseshin për këtë! Ata që nuk ranë në të as që e vërejnë ose nuk e konsiderojnë shirk. Një sqarim rreth kësaj është në vazhdim, in sha' Allah. Pra, dije se ky është shkaku primar pse Muslimanët janë nënshtruar ndaj ndëshkimeve të tilla.

Sikur ata të kishin qenë të kapur fort për fenë e tyre, ta realizonin



teuhidin dhe ta ngritnin akiden e tyre sipas Librit dhe Sunetit, të mbaheshin së bashku për Litarin e Allahut, ta shmangnin përçarjen, atëherë me të vërtetë ajo që i ka goditur nuk do t'i godiste, ashtu siç thotë Allahu6:

**“E Allahu patjetër do ta ndihmojë atë që ndihmon rrugën e Tij, se Allahu është shumë i fuqishëm dhe gjithnjë triumfues. (Ai ndihmon) Ata të cilët kur Ne u mundësojmë vendosjen në tokë, e falin namazin, japin zekatin, urdhërojnë për të mirën dhe largojnë prej të keqes. Allahut i takon përfundimi i çështjeve.”**

Kështu që Allahu e ka bërë të qartë se fitorja nuk do t'u jepet Muslimanëve përderisa ata të fokusohen në atë që Ai e ka cekur – faljen e namazit, dhënien e zekatit, urdhërimin për të mirën dhe ndalimin nga e keqja.

Ku janë këto tek Muslimanët dhe gjendja e tyre sot? Ku është falja e namazit nga shumica e Muslimanëve? Apo madje më e rëndësishmja, ku është 'akideja korrekte e shumicës së atyre të cilët e deklarojnë Islamin si fe të tyre?!

Allahu thotë7:

**“Atyre nga mesi jua j të cilët besuan dhe bënë vepra të mira, Allahu u premtoi se do t'i bëjë zotërues në atë tokë, ashtu si i pat bërë zotërues ata që ishin para tyre dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ta, do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t'ju dhurojë siguri...”**

Por cili është kushti i parë për këtë premtim?

**...Ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë**

Kështu Ai qartësoi se këtë shpërblim të autoritetit dhe fortifikimit do t'ua japë vetëm atëherë kur ky kusht të plotësohet –

që ta adhurojnë Atë të vetëm dhe pa shokë, dhe kjo është esenca e teuhidit. Këto gjëra të çmuara e të premtuara nuk do t'u dhurohen askujt përveç atyre që e kuptojnë dhe zbatojnë teuhidin, adhurojnë Allahun të vetëm e pa shokë, me aktet e adhurimit duke përfshirë namazin, zekatin, Haxhin si dhe të gjitha aktet tjera të bindjes.

---

6.Kuptimi i sures el-Haxh (22):41

7.Kuptimi i sures en-Nur (24):55

---

Shiko si Allahu i Lartësuar dhe i Lavdëruar nuk thotë vetëm: **“Ata më adhurojnë Mua”**, mirëpo Ai vazhdon me Thënien e Tij:

**... e nuk më shoqërojnë asgjë.**

Kjo është për shkak se adhurimi nuk ka dobi me prezencë të shirkut. Të gjitha format e shirkut duhet të mënjanohen, pavarësisht trajtës, formës apo emrit. Shirk thjesht nënkupton të kryesh një akt adhurimi për tjetër pos Allahut, të Fuqishmit dhe të Madhërishmit.

Kjo është ajo që sjellë shpëtimin e vërtetë, sigurinë, fitoren dhe fuqinë në tokë – rregullimi i ‘akides e pastaj rregullimi i veprave. Pa këtë,

fatkeqësitë dhe dënimet do të vazhdojnë të bien mbi këdo i cili nuk e përmbush komplet kushtin (për Ndihmën e Allahut). Të qenit të pushtuar nga armiqtë është vetëm për shkak se Muslimanët nuk e përmbushin këtë kusht të domosdoshëm, mangësia e interesimit të duhur për 'akiden dhe Fenë e tyre dhe të mjaftuarit me bartjen e emrave Muslimanë dhe asgjë më shumë.

## Domethënia e fjalës Teuhid

Ç'është në të vërtetë teuhidi i cili është aq i rëndësishëm, që ka një pozitë aq të lartë? Gjuhësisht, fjala teuhid rrjedh nga fjala *ueh-hade*, që ka kuptimin e të konsideruarit diçka *uahid* (njëjës). *Uahid* është e kundërta e dy, tre, etj., e kundërta e shumësit. Kështu që *uahid* është diçka që vazhdon të mbetet njëjës dhe asnjëherë nuk bëhet i shoqërueshëm me diçka tjetër.

Si definicion Sheriatik, teuhid do me thënë të veçosh Allahun me të gjitha format e adhurimit, në atë mënyrë që i tërë adhurimi të bëhet vetëm për Allahun e vetëm. Allahu

thotë:8

**“... e tërë feja të jetë vetëm për Allahun.”**

Fjala fe në këtë varg do me thënë adhurim, siç thotë Allahu:9

**Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë.**

Dhe Allahu thotë:10

**“Adhurojeni Allahun e mos i shoqëroni Atij asnjë send.”**

Allahu poashtu thotë:11

**“Pra, adhurojeni Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij, edhe pse jobesimtarët e urrejnë atë.”**



Ky është kuptimi i teuhidit – të veçosh Allahun në të gjitha format e adhurimit dhe braktisja e adhurimit ndaj dikujt tjetër.

---

8. Kuptimi i Sures el-Enfal (8):39  
9.Kuptimi i Sures edh-Dharijat (51):56 10.Kuptimi i Sures en-Nisa' (4):36 11.Kuptimi i Sures Gafir (40):14
-

## Kategoritë e teuhidit

Teuhidi ka tri kategori që kuptohen direkt nga Libri i Allahut. Kjo ndarje e teuhidit nuk është për shkak të opinionit të ndokujt, dhe as si mënyrë e thjeshtë tradicionale për ta shpjeguar teuhidin. Është një ndarje që është marrë direkt nga Libri i Allahut.

Kategoria e parë është teuhidi er-rububijeh, që do me thënë "të veçosh Allahun në kuptimin e Veprave të Tij", si krijimin e Tij, furnizimin, sjelljen e jetës dhe vdekjes, mbajtjen e rregullit në të gjitha çështjet. Personi kupton se Allahu i vetëm është Krijues,

Furnizues, i Përrjetshëm, i njoftuar për të gjitha çështjet.

Kategoria e dytë është teuhidi el-uluhijeh, që do të thotë “të veqosh Allahun në aktet e adhurimit.” Kjo përfshin të gjitha aktet që të shpijnë më afër Allahut, të Lavdëruar dhe të Lartësuar, si:

*Du'a'* – lutja *Khauf* – frika *Rexha'* – shpresa

*Rehbeh* – frikë-respekti

*Regbeh* – përgjërimi (dashuria e zjarrtë)

*Teuekul* – mbështetja

*Isti'aneh* – kërkimi i mbrojtjes

*Istighadheh* – kërkimi i mbrojtjes gjatë fatkeqësive

*Dhebh* – therrja (kurbani)

*Nedhr* – betimi

Të gjitha format e adhurimit duhet të jenë saktësisht vetëm për Allahun dhe asgjë nuk guxon të bëhet për tjetër pos Tij. Kjo është ajo që quhet teuhid el-‘ibadeh apo teuhid el- uluhijeh, dhe ky është teuhidi që vihet në praktikë ashtu që robi e veçon Allahun në të gjitha që Ai i ka kërkuar, duke pasur për qëllim vetëm Atë, në të gjitha aktet e bindjes.

Kategoria e tretë është teuhidi el-esma’ ues-sifat, që do të thotë “të besosh në secilin Emër dhe Cilësi që

Allahu ka pohuar për Vetën e Tij, apo ato që i Dërguari (salallahu 'alejhi ue selem) ka pohuar për Të."

Këto tri kategori kuptohen direkt nga Libri i Allahut. Secili varg që përmend Veprat e Allahut, si krijimi, furnizimi, sjellja e jetës dhe vdekjes dhe kontrollimi i çështjeve, përkshkruan teuhidin er-rububijeh. Kjo vërehet shpesh në Kur'an. Allahu thotë:12

**Thuaj: "E kujt është toka dhe çdo gjë që ka në të, nëse jeni që e dini?" Ata do të thonë: "E Allahut". Atëherë thuaju: "Përse pra nuk mendoni?" Thuaj: "Kush është Zoti i shtatë qiejve dhe Zot i Arshit të**

madh?" Ata do të thonë: "Allahu!".  
 Thuaju: "E pse nuk frikësoheni  
 pra?" Thuaj: "Në dorën e kujt është  
 i tërë pushteti i çdo sendi, dhe Ai  
 është që mbron (kë të dojë), e që  
 prej Atij nuk mund të ketë të  
 mbrojtur; nëse jeni që e dini?" Ata  
 do të thonë: "Në dorë të Allahut!"  
 Thuaj: "E si mashtroheni pra?"

Allahu po ashtu thotë:13

Thuaj: "Kush ju furnizon me  
 ushqim nga qielli e toka, kush e ka  
 në dorë të dëgjuarit e të parët  
 (tuaj), kush e nxjerr të gjallin nga i  
 vdekuri e kush e nxjerr të vdekurin  
 nga i gjalli, kush rregullon çdo  
 çështje?" Ata do të thonë: "Allahu".

**Ti thuaj: "A nuk i frikësoheni?".**

Ngjashëm, secili varg që përmend krijimin e qiejve dhe tokës apo gjëra tjera të krijuara ka të bëjë teuhid er-rububijeh.

---

12.Kuptimi i Sures el-Mu'minun (23):84-89

13.Kuptimi i Sures Junus (10):31

---

Çdo varg që përmend adhurim, goftë ndonjë urdhër për adhurimin e Allahut apo ndonjë ndalesë prej shirkut, ka të bëjë me teuhid el-uluhijeh.

Çdo varg që përmend diçka rreth Emrave dhe Cilësive të Allahut ka të bëjë me teuhid el-esma' ues-sifat.

Të gjitha këto kategori gjinden në Librin e Allahut, dhe kjo është që lejon dijetarët të thonë, “Teuhidi ka tri kategori: uluhijeh, rububijeh dhe el-esma' ues-sifat.” Ata nuk e kanë shpikur këtë ndarje nga mendja e tyre, mirëpo është diçka direkt nga Libri i Allahut. Unë do të elaboroj rreth kësaj më vonë, in sha'Allah.<sup>14</sup>

---

14. Shiko Pjesën Shtatë nga kjo renditje

---



## Kuptimi i teuhidit sipas filozofëve

Ka edhe prej atyre që thonë se teuhidi është vetëm një kategori – teuhidi er-rububijeh. Kjo është ta njohësh Allahun si Krijues, Furnizues, Sjellës të jetës dhe vdekjes, etj. Ata u referohen vetëm veprave të Allahut dhe Atributeve të Tij. Përmbi këtë mendim, mendimtarët filozofë dhe njerëzit e mendimit të lirë e kanë ndërtuar akiden e tyre.

Besimet e tyre gjinden në librat e tyre dhe nëse keni pasur rast t'i lexoni ato, me siguri keni parë se ata e pohojnë vetëm teuhidin er-

rububijeh. Pra, kaq u intereson atyre.

Kushdo që dëshmon se është i njoftuar për të, kjo është në teuhid tek ata. Ata nuk kanë fare njohuri për teuhidin el-uluhijeh dhe as për teuhidin el-esma' ues-sifat, kështu që ata nuk e konsiderojnë adhurimin e varrit apo thirrjen e të vdekurit për shirk. Ata vetëm thonë, “Kjo është për qëllim të dikujt tjetër pos Allahut, dhe është gabim,” por ata nuk thonë se kjo është shirk.

Disa nga ata thonë, “Me të vërtetë këta njerëz të cilët i thërrasin të vdekurit dhe kërkojnë ndihmë prej të varrosurve në varreza nuk janë

njerëz të shirkut, sepse ata nuk besojnë se këta njerëz të vdekur apo objekte tjera adhurimi mund të krijojnë diçka dhe as nuk mund të furnizojnë apo të kontrollojnë çështjet së bashku me Allahun. Përderisa ata nuk e besojnë këtë, ata nuk janë mushrikun. Këto akte nuk konsiderohen shirk, ata vetëm i marrin këto gjëra si ndërhyrës dhe ndërmjetësues në mes tyre dhe Allahut!!”

Këto janë thëniet e tyre dhe janë të njëjta me thëniet e politeistëve të vjetër, të cilët thoshin:15

**“Ne nuk i adhurojmë ata për tjetër, vetëm që të na afrojnë sa më**

**afër Allahut."**

Dhe Allahu thotë për t'a:16

**Ata pos Allahut adhurojnë çdo gjë që nuk u bën as dëm e as dobi, e thonë: "Këta janë ndërmjetësuesit tanë te Allahu!"**

Filozofët thonë, "Vërtet nuk është shirk adhurimi i varreve dhe as thirrja e të vdekurve apo kërkimi i ndihmës prej tyre. Kjo është thjesht *teuesul* (të kërkuarit që të afrohesh më afër Allahut), kërkim i ndërhyrjes dhe ndërmjetësimi në mes neve dhe Allahut. Kjo nuk është shirk deri sa ata të besojnë se këto gjëra krijojnë, furnizojnë, apo kontrollojnë çështjet së bashku me

Allahun!”

Kjo gjindet veçanërisht në librat dhe fletushkat e tyre. Disa filozofë që shfaqin ndonjë pakënaqësi për rënien e njerëzve në këtë thjesht thonë, ”Kjo është vetëm një gabim, meqë këta njerëz janë injorantë dhe kanë rënë në këtë gabim me injorancën e tyre, jo qëllimisht.”

Përndryshe shumica e tyre nuk shfaqin ndonjë neveri për këtë, mirëpo thonë, ”Kjo është ndërmjetësim dhe ndërhyrje tek Allahu, nuk është shirk.”

15.Kuptimi i Sures ez-Zumer (39):3

16.Kuptimi i Sures Junus (10):18

Nuk jam duke jua mveshur këtyre njerëzve gjërat që nuk i kanë thënë. Këto thënie janë prezente në librat e tyre në të cilat përgënjeshtrojnë njerëzit e teuhidit dhe mbrojnë njerëzit e shirkut.

Sa për Emrat dhe Cilësitë e Allahut, ata besojnë së afirmimi i tyre do të imponojë të bërit Allahun si krijesën e Tij, kështu që ata i mohojnë ato. Ata si Xhehmijeh, Mu'tezileh, Esh'ari dhe Maturidijeh,

mohojnë teuhidin el-esma'ues-sifat, me mendimin se e ruajnë Madhështinë e Allahut duke mos e përngjasuar Atë me krijesat. Kështu që teuhidi sipas tyre është i kufizuar vetëm në teuhid er-rububijeh, dhe ata nuk kanë fare njohuri për teuhidin el-uluhijeh, dhe as ndojnë njohuri për teuhidin el-esma' ues-sifat.

Ata i nënçmojnë ata që e ndajnë teuhidin në tri kategori aq shumë, saqë njëri prej shkrimtarëve modern të tyre shkruan, "Ndarja e teuhidit në tri kategori është diçka nga Triniteti!" Paturpësia e tyre ka arritur deri në këtë pikë, saqë ata e

quajnë këtë ndarje një imitim i të Krishterëve, dhe Strehimi është tek Allahu!

## **Hakimijeh: Një gabim si kategori e teuhidit**

Janë disa në kohën tonë të cilët e kanë ndarë teuhidin në katër kategori, duke thënë, “Teuhidi është katër kategori: teuhidi er-rububijeh, teuhidi el-uluhijeh, teuhidi el-esma’ ues-sifat dhe teuhidi el-hakimijeh.” Për ta thënë këtë, ata mbështeten në idenë se ndarja e teuhidit është vetëm një mënyrë tradicionale për shpjegimin e tij, jo diçka e kufizuar. Bazuar në këtë supozim, asgjë nuk na pengon nga shtuarja e edhe një



kategorie.

Atëherë, duhet t'i themi një personi të tillë: “Kjo ndarje nuk është një shpjegim tradicional. Më saktë, kjo bazohet në Libër dhe Sunet, dhe Selefi i nxorrën këto tri kategori direkt nga Libri dhe Suneti.”

Sa për hakimijeh, atëherë kjo është e vërtetë. Është obligim për ne që të udhëheqim me Sheri’at të Allahut, të Fuqishmit dhe të Madhërishmit. Mirëpo, kjo është e përfshirë në teuhid el-uluhijeh, sepse është bindje ndaj Allahut, të Fuqishmit dhe të Madhërishmit.

Selefi nuk e kanë lënë anash teuhidin el-hakimijeh në mënyrë që dikush më vonë të dalë edhe ta shtojë atë. Vërtet ai për ta ka qenë gjithnjë brenda teuhidit el-'ibadeh (teuhid el- uluhijeh)! Kjo është sepse bindja ndaj Allahut duke udhëhequr në përputhje më Sheriatin e Tij është prej formave të adhurimit ndaj Tij, të Fuqishmit dhe të Madhërishmit, kështu që ai nuk ndahet në kategori të veçantë. Përndryshe, namazi do të ishte një kategori e veçantë e teuhidit, pagesa e zekatit do të ishte kategoria tjetër, agjërimi tjetra, Haxhi tjetra, si dhe të gjitha format tjera të adhurimit do të ishin kategori të veçanta po ashtu,

dhe kështu nuk do të përfundonin ndarjet e teuhidit! Ky është gabim i qartë. Të gjitha format e adhurimit vijnë nën një kategori: teuhid el-uluhijeh. Kjo kategori përfshin atë (el-hakimijeh), dhe asgjë nuk duhet të shtohet në to.

Ekziston një grup nga ata që e shtojnë një kategori tjetër, të pestën. Ata e quajnë atë itiba' er-resul (pasimi i të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem). Edhe kjo po ashtu është gabim. Pasimi i të Dërguarit është detyrim dhe nuk ka rrugë tjetër pos saj, aq sa pasimi i të Dërguarit (sallallahu aleji ue selem) është prej gjërave bashkërendëse të

teuhidit, saqë asnjë dëshmi e “la ilahe il Allah” nuk vlen pa dëshminë “Muhamedi është i Dërguari i Allahut.” Kështu që kjo dëshmi për profetësinë e të Dërguarit tregon dëshminë e vërtetë të teuhidit. Kështu që pasimi i të Dërguarit është prej gjërave që janë detyrim për këdo që pohon të jetë në teuhid, jo kategori e veçantë e teuhidit. Ai që shkel teuhidin quhet mushrik apo kafir, përderisa ai që nuk e pason të Dërguarin është *mubtedi'* (risimtar).

Këta janë ata të cilët kundërshtojnë Ehlu-Sunetin në ndarjen e teuhidit dhe janë ose

teprues, ose shtrëngues. Tepruesit shtojnë në tri kategoritë e teuhidit pa nevojë, përderisa shtrënguesit mbahen në vetëm një kategori, duke lënë anash dy tjerat<sup>17</sup>.

Shtrënguesit e lëjnë anash atë më të rëndësishmen, atë që kërkohet prej nesh që ta përmbushim, teuhidin el-uluhijeh.

Sa për teuhid er-rububijeh, secili popull është pajtuar më të, me përjashtim të një pakice nga Krijimi. Ata e kanë kundërshtuar atë vetëm nga krenaria dhe kokëfortësia, përderisa ata në brendi e pohojnë atë. Kështu që të gjitha krijesat pohojnë se Allahu është Krijuesi,

Furnizuesi, Sjellësi i Jetës dhe Vdekjes dhe Kontrolluesi i Çështjeve, megjithatë kjo nuk është forma e teuhidit që kërkohet nga ne<sup>18</sup>.

---

17.Shiko Pjesa katër: Kuptimi i teuhidit sipas filozofëve 19.Shiko Pjesa gjashtë: Teuhidi që kërkohet nga njerëzimi

---

## **Teuhidi që kërkohet nga njerëzimi**

Teuhidi që kërkohet nga ne është teuhidi el-uluhijeh. Të gjithë të Dërguarit filluan duke thirrur njerëzit e tyre në<sup>19</sup>:

**“Adhurojeni Allahun, nuk keni zot tjetër pos Tij.”**

Ata filluan kështu, duke thirrur në teuhid el-uluhijeh, siç tregon Kur’ani për ta. Kjo është sepse për teuhidin el-uluhijeh njerëzit janë të padijshëm dhe Shejtani tenton që t'i largojë ata sa më larg nga kuptimi i drejtë i tij.

Sa për teuhid er-rububijeh, kjo është diçka e njohur dhe vazhdimisht prezente përbrenda shpirtrave. Nuk është i mjaftueshëm vetëm robërimi. Nuk e bën dikë besimtar dhe as nuk mund të hyjë dikush në rrethin e teuhidit me anë të tij. Kjo është sepse i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) luftoi jobesimtarët nga Kurejshitët, përderisa ata besonin se Allahu është Krijues, Furnizues, Kontrollues i çështjeve dhe Ai që sjell jetën dhe vdekjen. Ai i luftoi ata, duke deklaruar gjakun e tyre të lejuar, derisa e dëshmuan teuhidin el- uluhije. Ai (salallahu alejhi ue selem) ka thënë:



“Jam urdhëruar që t'i luftoj njerëzit deri sa të thonë 'La ilahe il Allah'. Por nëse ata e thonë këtë, atëherë gjaku dhe prona e tyre janë të mbrojtura prej meje, vetëm se me të drejta të tij (shehadetit)<sup>20</sup>, dhe llogaria e tyre do të jetë tek Allahu.”<sup>21</sup>

Kjo është dëshmi se gjëja më e rëndësishme e kërkuar nga krijesat është teuhidi el- uluhije, përderisa ai (salallahu alejhi ue selem) nuk thotë, “Jam urdhëruar t'i luftojë njerëzit deri sa ata të dëshmojnë se Allahu është Krijues, Furnizues, dhe Sjellësi i jetës dhe vdekjes.” Secili pajtohet me këtë. Për më tepër ai thotë:

**“... derisa të thonë ‘la ilahe il  
Allah’”**

Kjo e ka kuptimin deri sa ata të dëshmojnë se nuk ka të adhuruar me meritë përveç Allahu.

19. Kuptimi i Sures el-Araf (9):59

20. Shënim i përkthyesit: si marrëdhëniet jashtë kurorës, për shembull, apo konfiskimi i zekatit nga ata që e mbajnë atë.

21. Një transmetim autentik i mbledhur nga el-Buhari (#2946) dhe Muslim (#21)

## **Tri kategoritë e teuhidit janë të përcaktuara në Kur'an**

Ne pak më parë cekëm se tri kategoritë e teuhidit janë të nxjerra direkt nga Kur'ani Fisnik. Kategoritë janë nxjerrë prej disa vargjeve. Atëherë, le të shikojmë në disa prej tyre.

Kaptina e parë që gjendet në mus-haf, Sureja el-Fatihah, përmend të tri kategoritë e teuhidit. Allahu thotë<sup>22</sup>:

**“I gjithë Lavdi dhe Falënderimi i takon Allahut, Zotit të tërë asaj që ekziston!”**

Këtu është teuhidi er-rububijeh, përderisa vargu pohon Zotërimin e Allahut mbi *'alemin*, që do të thotë gjithçka përveç Allahut, dhe Rab (Zot) do të thotë Pronar dhe Kontrollues i Çështjeve. Allahu pastaj thotë<sup>23</sup>:

**“Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!  
Sunduesit të Ditës së Gjykimit.”**

Në këto vargje është prezent teuhidi el-esma' ues-sifat, ashtu siç Allahu pohon për Vetën e Tij atributet e Mëshirës dhe Sundimit. Ai gjithashtu përshkruan disa nga Emrat e Tij – er-Rahman, er-Rahim, dhe el-Malik. Pastaj Ai thotë<sup>24</sup>:

**“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje kërkojmë ndihmë.”**

Ndërsa këtu është teuhidi el-uluhije, siç demonstroi vargu detyrimin për ta veçuar Allahun me aktet e adhurimit dhe të kërkuarit ndihmë vetëm prej Tij.

Ngjashëm, tri kategoritë e teuhidit gjithashtu gjinden në Suren en-Nas, kaptina e fundit që gjindet në mus-haf. Teuhidi er-rububijeh gjindet në Thënien e Tij<sup>25</sup>:

**Thua: ‘Mbështetem (mbrohem) me Zotin e njerëzve’**

Ndërsa teuhidi el-esma' ues-sifat gjendet në Thënjen e Tij<sup>26</sup>:

### **Sunduesin e njerëzve**

Dhe së fundi, teuhidi el-uluhijeh gjendet në Thënjen e Tij<sup>27</sup>:

### **Të adhuruarin e njerëzve**

Po ashtu, urdhri i parë që haset në mus-haf përmban kategoritë e teuhidit<sup>28</sup>:

O njerëz, adhurojeni Zotin tuaj, i cili ju krijoi juve edhe ata që ishin para jush ashtu që të jeni të devotshëm. Ai, i cili për ju bëri tokën shtrat e qiellin kulm, e prej qiellit ju lëshoi shi me të cilin ju siguroi lloje të frutave si ushqim për

ju. Pra mos i përshkruani All-llahut  
shokë, duke qenë se ju e dini!

---

22.Kuptimi i Sures el-Fatihah (1):2

23.Kuptimi i Sures el-Fatihah

(1):3-4 24.Kuptimi i Sures el-

Fatihah (1):5 25.Kuptimi i Sures

en-Nas (114):1 26.Kuptimi i

Sures en-Nas (114):2 27.Kuptimi

i Sures en-Nas (114):3

28.Kuptimi i Sures el-Bekerah

(2):21-22

---

Pas përmendjes së tri llojeve të njerëzve, besimtarë, jobesimtarë dhe hipokritë, dhe pastaj duke marrur Mirësitë e Tij në Kur'an si burim të drejtimit<sup>29</sup>, Ai vazhdoi duke thënë<sup>30</sup>:

**“O njerëz! Adhurojeni Zotin tuaj!”**

Kjo është një thirrje e përgjithshme, një urdhër për të gjitha krijesat, që të veçojnë Allahun në aktet e adhurimit, dhe urdhër për t'u larguar nga përshkruarja shok Allahut. Ky është teuhidi el-uluhiyeh.



Pastaj Allahu vazhdon me teuhid er-rububijeh, si diçka për ta mbështetur faktin se Ai meriton të adhurohet i vetëm<sup>31</sup>:

**Ai, i cili për jua bëri tokën shtrat  
e qiellin kulm, e prej qiellit ju  
lëshoi shi me të cilin ju siguroi  
lloje të frutave si ushqim për ju**

A nuk janë këto veprat e Allahut, Më të Lartit dhe të Madhërishmit? Ky është teuhidi er-rububijeh. Allahu, i Madhërishëm dhe i Lartësuar, përmend atë si dëshmi dhe diçka që drejton kah teuhidi el-uluhijeh. Ashtu si Ai i vetëm i ka bërë këto gjëra, atëherë askush tjetër pos Tij nuk meriton adhurim, për

më tepër kjo është një e drejtë që është krejtësisht dhe vetëm për Atë, Më të Madhërishmin.

Ai përmend dy nga kategoritë e teuhidit në këto vargje. Teuhid el-uluhijeh përmendet përderisa është gjëja më e rëndësishme e kërkuar nga njerëzit, dhe teuhidi er-rububijeh përmendet si dëshmi për të, dhe si diçka që nuk mund të ndahet nga ai. Ai urdhëron të gjithë njerëzit me të njëjtin urdhër që gjendet në një varg tjetër<sup>32</sup>:

**“Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë.”**

Pra, Ai na ka informuar se këto dy krijesa të mrekullueshme, Xhinët dhe njerëzit, nuk janë krijuar për ndonjë qëllim tjetër përpos për adhurimin e Allahut, duke veçuar Atë me teuhid el-uluhijeh.

Pastaj Ai ndaloi shirkun në pjesën e fundit të vargut<sup>33</sup>:

**“Pra mos i përshkruani Allahut shokë duke qenë se ju e dini.”**

Me kuptim që nuk duhet kryer asnjë akt adhurimi për tjetër pos Allahut, përderisa e dini se askush tjetër nuk bën pjesë në Rububijetin e Tij, Krijimin e Qiejve dhe Tokës, dërgimin e shiut, rritjen e bimëve, etj. Përderisa e dini se askush tjetër

nuk bën pjesë me Të në këto çështje, atëherë si mund të adhuroni dikë tjetër pos Tij?! Allahu, Më i Lartësuari dhe i Madhërishmi, thotë<sup>34</sup>:

**“Dhe Zoti juaj është një Zot, nuk ka zot tjetër pos Tij.”**

---

29. Shenim i përkthyesit: në 20 vargjet e para të Sures el-Bekarah 30.Kuptimi i Sures el-Bekarah (2):21

31. Kuptimi i Sures el-Bekarah (2):21-22 32.Kuptimi i Sures edh-Dharijat (51):56 33.Kuptimi i Sures el-Bekarah (2):22 34.Kuptimi i Sures el-Bekarah (2):163

---

Ky është teuhidi el-uluhijeh. Zot është diçka që adhurohet, kështu që uluhijeh është adhurim dhe dashuri e plotë. Vargu ka kuptimin që ai i cili me të drejtë meriton adhurimin tuaj është një, nuk ka Zot tjetër pos Tij, nuk ka ndonjë që të adhurohet pos Tij. Më pas në varg, Allahu thotë<sup>35</sup>:

**“... që është Mëshirëplotë, gjithnjë mëshiron.”**

Kjo është diçka nga teuhidi el-esma' ues-sifat, meqë përmban dëshminë për dy nga Emrat e Allahut, i vetëm me Cilësinë e Tij të Mëshirës.

Allahu po ashtu thotë<sup>36</sup>:

**Është fakt se në krijimin e qiejve e të tokës, në ndërrimin e natës e të ditës, të anijes që lundron në det që u sjell dobi njerëzve, në atë shi që e lëshon Allahu prej së larti e me të ngjall tokën pas vdekjes së saj dhe përhap në të nga çdo lloj gjallese, në qarkullimin e erërave dhe reve të nënshtruara mes qiellit e tokës, për një popull që ka mend ka argumente.**

Ky varg është për teuhidin er-rububijeh. Allahu përmend këto gjëra si dëshmi për të Drejtën e Tij që të adhurohet i vetëm, përderisa Ai i quan këto gjëra ajete, që do të

thotë dëshmi dhe evidenca për të Drejtën e Tij që të adhurohet i vetëm.

Në këto vargje, janë përmendur të tri kategoritë e teuhidit dhe në të njëjtën mënyrë i gjen ato të përmendura përgjatë Kur'anit.

---

35.Kuptimi i Sures el-Bekarah (2):163 36.Kuptimi i Sures el-Bekarah (2):164

---

## **Urtësia e përsëritjes së pohimit të teuhidit er-rububije në Kur'an**

Në Kur'an Allahu e përmend teuhidin er-rububijeh, atë që mosbesimtarët e pohojnë përbrenda vetës, për të treguar peshën e tij si dëshmi dhe për të ngritur evidencë për teuhidin el-uluhijeh. Kështu që Allahu sjell një ide që ata pajtohen me të si dëshmi kundër tyre, the kjo i detyron ata të përgjigjen në këto pyetje:

- Si mund të pranoni Rububijetin e Allahut, i cili është Zot i krijesave, dhe të mos pajtoheni që Ai i vetëm duhet të



adhurohet?!

- Si mund të adhuroni dikë apo diçka që nuk ka hise në asnjë pjesë të krijimit me Allahun?! Kjo është një kontradiktë e çartë, siç thotë Allahu i Plotëfuqishëm<sup>37</sup>:

**“Thuaj: "Më thoni për ata që pos Allahut i adhuroni, më tregoni se çka krijuan ata në tokë dhe a kanë pjesëmarrje në (krijimin në) qiejtë? Nëse e thoni të vërtetën, më sillni ndonjë libër para këtij ose ndonjë gjurmë të mbetur prej diturisë".”**

Allahu gjithashtu thotë<sup>38</sup>:

**“Kjo është vepër e krijimit të Allahut, e më tregoni pra mua se ç'krijuan ata të tjerët pos Tij?”**

Dhe Allahu thotë<sup>39</sup>:

**“O ju njerëz, ja një shembull, vëni veshin pra: Vërtet ata që po i adhuroni në vend të Allahut, ata nuk mund të krijojnë asnjë mizë, edhe nëse tubohen të gjithë për të. Po ashtu, nëse miza ua rrëmben atyre ndonjë send, ata nuk do të mund ta shpëtojnë atë prej saj. Të dobët janë edhe lutësit edhe të luturit.”**

Pra, nëse miza sulmon njerëzit, ata nuk do të kenë mundësi të mbrohen apo të hakmerren, përderisa miza është gjëja më e dobët! Pra, nëse mizat dhe mushkonjat u bëjnë zhurmë atyre, ata nuk do të kenë mundësi që të shpëtojnë nga ato. Ata mund të jenë në gjendje t'i mbysin disa nga ato, por ato mund të jenë në numër shumë të madh ashtu që t'i mërzhisin të gjithë njerëzit!

Është thënë gjithashtu së kuptimi i vargut është se nëse miza merr diçka nga ndonjë idhull, ndonjë parfum apo dekorim që lënë njerëzit në të, vërtet idhulli nuk mund të

bëjë asgjë për ta kthyer atë që merr miza nga ai. Allahu thotë<sup>40</sup>:

**“Të dobët janë edhe lutësit edhe të luturit.”**

Në këtë varg, “lutësit” janë politeistët, “të luturit” janë idhujt. Dhe po ashtu është thënë se është për qëllim edhe vetë miza.

Pra, nëse çështja qëndron kështu, si mundet që këto gjëra të bëhen shokë me Allahun, Krijuesin, Furnizuesin, Sjellësin e Jetës dhe Vdekjes, më të Fortin, më të Fuqishmin, Ai që është i zoti për çdo gjë, i Lavdëruari dhe i Lartësuar?! Ku është intelekti?! Ku është të kuptuarit?! Kërkojmë falje

nga Allahu.

---

37. Kuptimi i Sures el-Ahkaf (46):4

38. Kuptimi i Sures Lukman (31):11

39. Kuptimi i Sures el-Haxh (22):73

40. Kuptimi i Sures el-Haxh (22):73

---

## **Shpjegimi i teuhidit në Ajetul-Kursi**

Allahu thotë në Ajetul-Kursi<sup>41</sup>:

**“Allahu është një. Nuk ka zot tjetër përveç Atij. Ai është mbikëqyrës i përhershëm dhe i përjetshëm. Atë nuk e kap as kotja as gjumë, gjithçka në qiej dhe në**

tokë është vetëm e Tij. Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai, pos me lejen e Tij. Ai e di të tashmen që është pranë tyre dhe të ardhmen. Nga ajo që Ai di, tjerët dinë vetëm aq sa Ai ka dëshiruar. Kursija<sup>42</sup> e Tij përfshin qiejt dhe tokën. Kujdesi i Tij ndaj të dyjave nuk i vjen rëndë. Ai është më i larti, më i madhi.”

Ky është vargu më madhështor në Librin e Allahut<sup>43</sup>, të Fuqishmit dhe të Madhërishmit. Ai përmban tri kategoritë e teuhidit: rububijeh, uluhijeh dhe esma’ ues- sifat. Allahu i ka përmbledhur ato të gjitha në këtë varg, duke përdorur mohimin

dhe pohimin, ku Ai mohon të metat dhe mangësitë për Vetën e Tij, dhe pohon përsosmërinë për Vetën e Tij, i Lartësuar dhe i pa të meta është Ai.

Në pjesën e parë të vargut përmendet teuhidi el-uluhijeh:

**“Allahu është një. Nuk ka zot tjetër përveç Atij.”**

Pastaj Allahu përmend teuhidin el-esma’ ues-sifat:

**“Ai është Mbikëqyrës i përhershëm dhe i përjetshëm.”**

Kjo pohon për Allahun cilësinë e jetës dhe se Ai mbikëqyr të tjerët<sup>44</sup>.

Pastaj Allahu thotë:

**“Atë nuk e kap as kotja as gjumi.”**

---

41. Kuptimi i Sures el-Bekarah (2):255

42. Shënim i përkthyesit: Kursi: ndenjëse (gjuhësisht). Transmetohet se ‘Abdullah ibn Abasi thotë: “Është vendi për dy shputat e këmbëve” (mbështetëse këmbësh). Shiko Tefsirin e Ibn Kethirit. Kjo po ashtu është transmetuar të jetë thënie e Ebu Musa el-Eshari, e gjetur në Tefsirin e el-Kurtubiut.



43. Shënim i përkthyesit: Bazuar në burimin e Ubej ibn Ka'bit, Allahu qoftë i kënaqur me të, ai thotë se Profeti (salallahu alejhi ue selem) thotë:

“O Eba Mundhir! A e din cili është vargu më madhështor në Librin e Allahut?” Ai u përgjigj, “Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri.” Profeti (salallahu alejhi ue selem) pastaj e goditi atë në gjoks dhe i tha: “Atëherë dituria qoftë e këndshme për ty, O Eba Mundhir!” Hadithi gjindet në Sahih Muslim (#1768) 44. Shënim i përkthyesit: Dhe dy nga Emrat e Tij po ashtu – el-Haj dhe el-Kajum.

---

Ky është një mohim. Allahu mohon se këto mangësi, kotja dhe gjumi, mund t'i atribuohen Atij.

Pastaj Allahu thotë:

**“... gjithçka në qiej dhe në tokë është vetëm e Tij.”**

Ky është një pohim i Rububijetit të Tij, se Ai posedon qiejt dhe tokën dhe gjithçka në to. Pastaj Ai, më i Lavdishmi, thotë:

**“Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai, pos me lejen e Tij?”**

Ky është një mohim. Allahu mohon që dikush mund të ndërmjetësojë pa Lejen e Tij, për shkak të Madhështisë së Tij, i Lavdëruar dhe i pa të meta qoftë Ai. Askush nuk ka mundësi të ndërmjetësojë tek Ai, përpos nëse Ai

e lejon atë. Pastaj Allahu thotë:

**“Ai e di të tashmen që është pranë tyre dhe të ardhmen.”**

Ky është një pohim që vërteton Diturinë e përsosur të Allahut, të Fuqishmit dhe Madhërishmit, Ai që di çdo gjë nga çështjet e të kaluaries, të tashmes dhe të ardhmes. Asgjë nuk është e fshehur prej Tij. Dituria e Tij është e gjerë dhe përfshin çdo gjë. Pastaj Ai, i Fuqishmi dhe i Madhërishmi, thotë:

**“... nga ajo që Ai di, tjerët dinë vetëm aq sa Ai ka dëshiruar.”**

Kjo është një mohim. Allahu anulon idenë se krijesat e Tij mund

të arrijnë diçka nga Dituria e Tij pa u dhënë Ai çasje në të. Pra nëse Ai nuk lejon ata të kenë njohuri për diçka, atëherë ajo konsiderohet gajb (e fshehtë), dhe askush nuk e di gajbin përveç Allahut. Pastaj Allahu thotë:

**“Kursija e Tij përfshin qiejt dhe tokën.”**

Kursi është gjë e krijuar nga krijesat e Allahut, dhe vërtet ajo është krijesë e madhe! Qiejt dhe toka në krahasim me Kursi janë sikur shtatë monedha të hedhura në një fushë të hapur të tokës<sup>45</sup>, apo si shtatë monedha të hedhura në një pllakë të madhe<sup>46</sup>. Si do të

dukeshin shtatë monedha të vogla në këtë situatë? Kështu që Kursija e Allahut është më e madhe se qiejt dhe toka. Kursija e Tij nuk është Froni i Tij, por janë dy gjëra të ndryshme. Froni është edhe më i madh se Kursija.

Dhe Kursija është vogëlsirë në krahasim me Fronin, vetëm se si një unazë hekuri e hedhur në një fushë të gjerë të tokës<sup>47</sup>. Pra nëse Kursija është kështu, atëherë çfarë të themi për Fronin e er-Rrahmanit, Më të Fuqishmit dhe Madhërishmit?!

45. Shënim i përkthyesit: Në shpjegimin e tij të Ajetul-Kursijit, Ibn Xherir et-Teberi sjell një transmetim nga Zejd ibn Thabiti (Allahu qoftë i kënaqur me të), ku Profeti (salallahu alejhi ue selem) gjoja ka thënë: “Shtatë qiejt janë vogëlsirë në krahasim me Kursinë, vetëm si shtatë monedha të vogla të hedhura në një fushë të gjerë.” Zingjiri i këtij është munketi’ (i këputur) siç e cekë Albani në Silsiletul-Ehadithis-Sahihah (#109), pas përmendjes së një numri transmetimesh me të njëjtin kuptim.

46. Shënim i përkthyesit: Nga thënia e Ebu Dherrit (Allahu qoftë i kënaqur me të), Profeti (salallahu alejhi ue selem) thotë: "Shtatë qiejt janë vogëlsirë në krahasim me Kursinë, përveç si një unazë e hedhur në një fushë të hapur të tokës." Kjo është marrë nga Muhamed ibn Ebi Shejbeh në librin e tij Kitab el-'Arsh (1/114), dhe Albani e vërteton në Silsiletul-Ehadithis-Sahihah (#109).

47. Shënim i përkthyesit: Ibn Kethiri sjell një transmetim nga Ebu Dherri, Profeti (salallahu alejhi ue selem) thotë:

"Kursija është vogëlsirë në krahasim me

Fronin, përveç si një unazë hekuri e hedhur në një fushë të hapur të tokës”

Albani e vërteton në kontrollimin e tij të el-Akideh et-Tehauijeh (f.280).

Prandaj, të gjitha krijesat në krahasim me Allahun janë shumë të vogla dhe çikërrimë në krahasim me Të. Nëse vetëm një gjë nga krijesat e Allahut, Kursija, është më e madhe se qiejt dhe toka, por prapë më e vogël se Froni, atëherë Allahu, i Fuqishmi dhe i Madhërishmi, është më i madh se çdo gjë. Allahu pastaj thotë:

**“Kujdesi i Tij ndaj të dyjave (qiejve dhe tokës), nuk i vjen rëndë.”**



Ky është një mohim, me kuptimin që asgjë nuk është e vështirë apo e rëndë për Të, më të Lavdishmin. Mbrojtja dhe ruajtja e qiejve dhe e tokës nga çrregullimi dhe devijimi nuk e lodh Atë, dhe as mbajtja e tyre në vend nuk i shkakton Atij asnjë lodhje<sup>48</sup>:

**“Ai mban qiellin të mos bie në tokë, pos nëse dëshiron Ai.”**

Dhe Allahu thotë<sup>49</sup>:

**“Allahu është Ai që ngriti qiejt pa ndonjë shtyllë. Ju i shihni ato.”**

Dhe Allahu gjithashtu thotë<sup>50</sup>:

**“Allahu i mban qiejt dhe tokën që të mos rrëshqasin nga vendet e tyre.”**

Dhe Allahu i Lavdishëm nuk ka nevojë për qiejt as për tokën, dhe as për Fronin as për Kursinë, dhe as që ka nevojë për diçka nga gjërat që Ai i ka krijuar. Janë krijesat që kanë nevojë shumë të madhe për Të, më të Fuqishmin dhe të Madhërishmin.

Sa për pjesën e fundit të Ajetul-Kursi:

**“Ai është më i larti, më i madhi.”**

Allahu është el-‘Alij (më i Larti) më Prezencën e Tij, Fuqinë dhe

Varësinë për Mirësitë e Tij. Ai është el-'Adhim (më i Madhi), për nga Madhësia e Tij dhe Krenaria.

Ky varg, Ajetul-Kursi, siç u shpjegua, përmban përmendjen e të tri kategorive të teuhidit.

---

48.Kuptimi i Sures el-Haxh (22):65

49.Kuptimi i Sures er-Ra'd (13):2

50.Kuptimi i Sures Fatir (35):41

---

**Përktheu: K.G.**

## Përmbajtja

|                                                                          |    |
|--------------------------------------------------------------------------|----|
| Rëndësia e teuhidit dhe pasojat nga mospërfillja e tij .....             | 2  |
| ...Ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë.....                   | 18 |
| Domethënia e fjalës Teuhid .....                                         | 22 |
| Kategoritë e teuhidit .....                                              | 25 |
| Kuptimi i teuhidit sipas filozofëve ...                                  | 32 |
| Hakimijeh: Një gabim si kategori e teuhidit .....                        | 39 |
| Teuhidi që kërkohet nga njerëzimi ...                                    | 46 |
| “... derisa të thonë ‘la ilahe il Allah’” .....                          | 49 |
| Tri kategoritë e teuhidit janë të përcaktuara në Kur’an.....             | 50 |
| Urtësia e përsëritjes së pohimit të teuhidit er-rububije në Kur’an ..... | 63 |
| Shpjegimi i teuhidit në Ajetul-Kursi.                                    | 68 |

|                    |    |
|--------------------|----|
| Përktheu: K.G..... | 82 |
|--------------------|----|